

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**PML.-KZZ. Nr. 62/2013**  
**Prishtinë**  
**22 maj 2013**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga  
Gjyqtari i EULEX-it Dr. Horst Proetel si kryetar i kolegjit,  
Gjyqtarja e Gjykatës Supreme Marije Ademi dhe  
Gjyqtarja e Gjykatës Supreme Emine Mustafa si anëtare të kolegjit,

në lëndën penale kundër të pandehurit:

**S Z**

I akuzuar sipas aktakuzës PP. 2967-3/2009, të datës 2 tetor 2009, të ndryshuar në shqyrtimin gjyqësor të datës 21 tetor 2010 dhe 5 prill 2011, për kryerje të disa pikave të veprave penale:

- a) **Shpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin** sipas nenit 200 paragrafit 2 pikës 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së),
- b) **Marrja e ryshfetit** sipas nenit 343 paragrafit 1 të KPK-së,
- c) **Shpërdorim i pozitës zyrtare apo i autorizimit** sipas nenit 339 paragrafit 2 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së dhe
- d) **Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrave** sipas nenit 164 paragrafit 1 të KPK-së.

Me aktgjykimin P. 1960/09, të datës 7 prill 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë ka liruar të pandehurin nga akuzat për veprën penale:

**Shpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin** sipas nenit 200 paragrafit 2 pikës 1 të KPK-së (pika 4) dhe

**Marrja e ryshfetit** sipas nenit 343 paragrafit 1 të KPK-së, (pika 7) dhe

Ka shpallur të pandehurin fajtor për:

- a) **Shpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin** sipas nenit 200 paragrafit 2 pikës 1 të Kodit Penal të Kosovës KPK-së, (pika 1) dhe e ka dënuar atë me gjashtë (6) muaj burgim dhe me dënim plotësues të

ndalimit të ushtrimit të funksionit në administratën publike apo shërbim publik për tre (3) vite;

- b) **Shpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin në tentativë** sipas nenit 200 paragrafit 2 pikës 1 në lidhje me nenin 20 të KPK-së (pika 3 e ri-cilësuar) dhe e ka dënuar atë me katër (4) muaj burgim dhe me dënim plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksionit në administratën publike apo shërbim publik për tre (3) vite;
- c) **Marrja e ryshfetit** sipas nenit 343 paragrafit 1 të KPK-së, (pika 5) dhe e ka dënuar atë me një (1) vit dhe gjashtë (6) muaj burgim dhe me dënim plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksionit në administratën publike apo shërbim publik për tre (3) vite;
- d) **Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrave** sipas nenit 164 paragrafit 1 të KPK-së (pika 9 e ri-cilësuar) dhe e ka dënuar atë me gjashtë (6) muaj burgim dhe me dënim plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksionit në administratën publike apo shërbim publik për tre (3) vite;
- e) **Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrave** sipas nenit 164 paragrafit 1 të KPK-së (pika 10) dhe e ka dënuar atë me katër (4) muaj burgim dhe me dënim plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksionit në administratën publike apo shërbim publik për tre (3) vite;

Gjykata ka shqiptuar dënimin unik me (2) vjet dhe katër (4) muaj burgim dhe dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksionit në administratën publike apo shërbim publik për tre (3) vite.

Pas ankesës së të pandehurit, Gjykata e Qarkut në Prishtinë me aktgjykimin Ap.-Kž. 116/12, të datës 3 dhjetor 2012, **refuzoi** akuzat e pikës 1 (**Shpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin** sipas nenit 200 paragrafit 2 pikës 1 të KPK-së).

Ka **ndryshuar** sipas detyrës zyrtare dënimin për pikën 3 (**Shpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin në tentativë** sipas nenit 200 paragrafit 2 pikës 1 në lidhje me nenin 20 të KPK-së) duke e ndryshuar formulimin e dispozitivit nga 'maj apo qershor 2008' në 'nëntor apo dhjetor 2008'.

Ka **ndryshuar** pikën 9 duke e ri-cilësuar si **Shpërdorim i pozitës zyrtare apo i autorizimit** sipas nenit 339 paragrafit 1 të KPK-së.

Ka **liruar** të pandehurin nga akuzat e pikës 5 (**Marrja e ryshfetit** sipas nenit 343 paragrafit 1 të KPK-së) dhe

**Ka ndryshuar dënimin** në dënim unik me dymbëdhjetë (12) muaj burgim duke përfshirë kohën e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej 27 gushtit 2009 deri më 5 janar 2010 dhe me dënim plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksionit në administratën publike apo shërbim publik për dy (2) vjet, pas vuajtjes së dënimit;

Duke vendosur në lidhje me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur më 17 prill 2013 nga i pandehuri kundër aktgjykimit të formës së prerë Ap.-Kž. 116/12 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të datës 3 dhjetor 2012.

Lëshon këtë:

## AKTGJYKIM

**Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur më 17 prill 2013 nga i pandehuri kundër aktgjykimit të formës së prerë Ap.-Kž. 116/12 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të datës 3 dhjetor 2012, REFUZOHET SI E PABAZUAR.**

## ARSYETIM

### I. Historia e procedurës

Më 27 gusht 2009 i pandehuri **S. Z.** arrestua me dyshimin se ka kryer veprat e lartpërmendura penale. Prokurori paraqiti propozim për shqiptimin e masës së paraburgimit. Gjykata Komunale në Prishtinë refuzoi kërkesën dhe caktoi masën e paraburgimit.

Më 3 shtator 2009 është paraqitur propozim aktakuzë, e cila është ndryshuar me vepra të reja penale më 9 shtator 2009. Më 24 shtator 2009 gjyqtari për konfirmim të aktakuzës e ktheu aktakuzën me urdhër për zhvillim të mëtejshëm të hetimit. Më 2 tetor 2009 prokurori përsëri paraqiti aktakuzë duke akuzuar të pandehurin për dhjetë (10) pika të veprave të ndryshme penale.

Më 15 tetor 2009, aktakuza u konfirmua me aktvendimin KA. 274/09.

Më 23 nëntor 2009, pas kërkesës së prokurorit të EULEX-it, të mbështetur edhe nga Kryetari i Gjykatës Komunale në Prishtinë, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it vendosi që në këtë lëndë ta caktojë një gjyqtar të EULEX-it si kryetar kolegjii.

Më 18 tetor 2010 në Gjykatën Komunale në Prishtinë filloi shqyrtimi gjyqësor. Pas 16 shqyrtimeve, më 7 prill 2011, u shpall aktgjykimi i lartpërmendur P. Nr. 1960/2009.

Kolegji i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë më 3 dhjetor 2011 lëshoi aktgjykimin e formës së prerë Ap.-Kž. 116/12, pas ankesës së paraqitur më 9 gusht 2011 nga avokati mbrojtës **Bajram Tahiri** në emër të të pandehurit.

Më 17 prill 2013 i pandehuri **S.Z.** paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër aktgjykimit të lartpërmendur të formës së prerë të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ap.-Kž. 116/12.

Më 20 maj 2013 Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK) paraqiti përgjigje ndaj kërkesës së të pandehurit për mbrojtje të ligjshmërisë.

## **II. Gjetjet e Gjykatës Supreme**

### **1. Pranueshmëria e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pranueshme.

Sipas nenit 433 paragrafëve 1 dhe 2 të KPP-së, është paraqitur nga personi i autorizuar dhe brenda afatit ligjor. Vendimi i kontestuar i është dërguar të pandehurit më 16 janar 2013. Si rrjedhojë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur brenda afatit kohor sipas nenit 433 paragrafit 2 të KPP-së, brenda 3 muajve nga data e dorëzimit.

Vendimi i kontestuar është i formës së prerë në kuptim të nenit 432 paragrafit 1 të KPP-së.

### **2. Procedura e ndjekur nga Gjykata Supreme**

Kolegji i Gjykatës Supreme ka vendosur në seancë sipas nenit 435 paragrafit 1 të KPP-së.

### **3. Lidhur me meritat e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës ka kundërshtuar aktvendimin e përmendur mbi bazën e shkeljeve substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 432 paragrafit 1 pikës 1.2 në lidhje me nenin 384 paragrafin 1 pikat 1.8 dhe 1.10 dhe paragrafin 2 pikën 2.1 të KPP-së, shkelje të ligjit penale sipas nenit 432 paragrafit 1 pikës 1.1 të KPP-së dhe mbi bazën e vërtetimit të gabuar të fakteve sipas nenit 439 të KPP-së.

Mbrojtja pohon se Gjykata Komunale dhe Gjykata e Qarkut kanë shpallur të pandehurin fajtor kundërligjshëm për Shpërdorim seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin në tentativë sipas nenit 200 paragrafit 2 pikës 1 në lidhje me nenin 20 të KPK-së në lidhje me Policen ' √ G. luke e prekur atë në krahë dhe duke u munduar ta puthë. Përfundimisht, ai ka arritur ta puthë vetëm në faqe. Ai pretendon se tentativa kërkon që kryerësi qëllimisht të ndërmarrë veprim të menjëhershëm në drejtim të kryerjes së veprës. Prekja e një personi për qëllime seksuale duhet patjetër të manifestohet me disa veprime që fillojnë përfundimin e një qëllimi të tillë. Këtu fillimi i veprës penale nuk është provuar.

Gjykata gjen se pretendimi është i pabazuar. Neni 200 paragrafi 2 i KPP-së vetëm kërkon që: "Kushdo që prek një person tjetër për qëllime seksuale ..." Pasi që të dy aktgjykimet japin arsyetim të qartë, i pandehuri jo vetëm që ka prekur viktimën në krahë por është munduar që ta puthë atë, dhe vetëm me reagimin mbrojtës viktimja ka shmangur puthjen në gojë. Në vend të kësaj i pandehuri ka puthur viktimën në faqe. Prandaj, i pandehuri në rastin në fjalë nuk ka bërë tentativë por ka përfunduar veprën. Sidoqoftë, të dyja Gjykata Komunale dhe Gjykata e Qarkut në Prishtinë kanë gabuar në dobi të të pandehurit. Në përputhje me kufizimin *reformation in peius* (neni 436 paragrafi 3 në lidhje me nenin 395 të KPP-së) Gjykata Supreme nuk ka qenë e lejuar që të ndryshoj cilësimin juridik të veprës penale.

Ankesa gjithashtu kundërshton se i pandehuri ka është shpallur fajtor për Shpërdorim seksual në tentativë edhe pse tentativa në këtë rast nuk është e dënueshme. Gjykata gjithashtu gjen se ky argument është i pa bazë.

Sipas nenit 20 paragrafit 2 të KPK-së vetëm tentativat e veprave penale të dënueshme me burgim me së paku tre (3) vite janë të dënueshme dhe për veprat tjera vetëm nëse shprehimisht është përcaktuar me ligj. Neni 200 paragrafi 2 i KPK-së parasheh dënimin me burgim deri në tre (3) vite. Si rrjedhojë, korniza e dënimit e përcaktuar për veprën përkatëse përfshinë tre (3) vite e përcaktuar si kufiri më i ulët me nenin 20 paragrafin 2 të KPK-së për dënueshmërinë e tentativës.

I pandehuri gjithashtu kundërshton aktgjykimin në bazë të vërtetimit të gabuar të fakteve. Sipas nenit 432 paragrafit 2 të KPK-së, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të paraqitet mbi bazën e vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike. Prandaj, Gjykata Supreme nuk ka pasur nevojë që të ekzaminojë këtë shkelje të pretenduar.

Parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 439 të KPP-së, i cili e obligon gjykatën sipas detyrës zyrtare që të anulojë një vendim dhe të urdhëroj rigjykim nëse në procedurë me kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ngritën dyshime të konsiderueshme në lidhje me saktësinë e vërtetimit të fakteve.

Gjykata gjen se kjo dispozitë nuk është e aplikueshme në procedurën aktuale. Nuk ekziston dyshim i konsiderueshëm sa i përket saktësisë së fakteve të vërtetuara pasi që Gjykata e Qarkut në vendimin e saj, pas vlerësimit të deklaratës së dëshmitares ' √

' G edhe një herë, ka arsyetuar bindshëm dhe në mënyrë të drejtë se pse e ka ndryshuar kohën e kryerjes së veprës penale nga 'maji apo qershori' në aktgjykimin e shkallës së parë në 'nëntor apo dhjetor'.

Për arsytet e lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si në dispozitiv, në bazë të nenit 437 të KPK-së.

**Kryetar i kolegjit**

**Procesmbajtës**

---

Dr. Horst Proetel  
Gjyqtar i EULEX-it

---

Holger Engelmann  
Zyrtar ligjor i EULEX-it

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**PML.-KZZ. Nr. 62/2013**  
**Prishtinë**  
**22 maj 2013**